



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr

Dt: 13.03.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11, 13 dhe 58. a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03L-040 , nenit 9.1,10 dhe 13.g të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale, pas shqyrtimit të kërkesës së Rrjetit të OJQ-ve të grave “Qeliza” me seli në Gjakovë , për mbështetje financiare të projektit teatror “Pjata prej druri”, e në harmoni me Marrëveshjen e Bashkëpunimit për realizimin e këtij projekti 10 nr.415-20617, me dt: 13.03.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

I. Miratohet kërkesa e së Rrjetit të OJQ-ve të grave “Qeliza” nr.10-400-19767 e dt: 11.03.2015 për realizimin e projektit teatrot “Pjata prej druri” , sipas regjisë së regjisorit Gëzim Kame dhe në bashkëveprim me Teatrin Profesional në Gjakovë, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione komunale në vlerë prej 13,570.00€ .

II. Lejohet pagesa e mjeteve financiare nga subvencionet e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në vlerë prej 13,570.00€ për subvencionimin e projektit teatror “Pjata prej druri” , në harmoni me Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Rrjetin e OJQ-ve të grave “Qeliza” nr.10-415-20617 .

III. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 13,570.00€, nga mjetet e fondit të subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë , Rini dhe Sport dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirollogarinë e Rrjetit të OJQ-ve të grave “Qeliza” në Gjakovë nr. 1140127194010172- ProCredit Bank .

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

CO: - Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Rrjetit të OJQ-ve të grave “Qeliza” rr. “Përmet Vula “ nr.25, Gjakovë
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari-Lila